

Takimi i 1531 -të , 10-12 qershor 2025 (DNJ)

Të drejtat e njeriut

H46-1 Durdaj dhe të tjerë dhe Nika kundër Shqipërisë (Kërkësat Nr. 63543/09 dhe 1049/17)

Monitorimi i ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane

Dokumentet referuese

DH-DD(2024)1173 , DH-DD(2024)1288

Kërkësat	Rasti	Vendimi i	Përfundimtar më	Treguesi për klasifikimin
63543/09	DURDAJ DHE TË TJERË	07/11/2023	07/02/2024	Problem kompleks
1049/17	NIKA	14/11/2023	14/02/2024	Problem kompleks

- Projekti i bashkëpunimit: 4117–Veprimi kundër krimit ekonomik në Shqipëri” (AEC-AL) i zbatuar në kuadër të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”

Përshkrimi i çështjes

Çështja *Durdaj dhe të tjerë* ka të bëjë me mungesën e zbatimit të plotë të detyrimit për kryerjen e hetimit efektiv për shkak të mangësive në fazën e gjyimit penal në lidhje me një shpërthim në vitin 2008 në objektin e çmilitarizimit të armëve në Gërdec që rezultoi në vdekje dhe plagosje. Gjykata Evropiane vendosi që kërkuesve nuk iu dha një mundësi e mjaftueshme për të marrë pjesë në gjyqin kundër të akuzuarve për incidentin e Gërdecit në të cilin të afërmit e tyre humbën jetën ose pësuan plagosje të rënda kërcënuese për jetën. Gjykata gjithashtu vendosi që procedimi penal ndaj ish-Ministrit të Mbrojtjes (F.M) u shoqërua me vonesa të konsiderueshme dhe inerci të autoriteteve të ndjekjes penale (shkelje procedurale e Nenit 2).

Çështja *Nika* ka të bëjë me përdorimin e pajustificuar të forcës vdekjeprurëse nga oficerët e Gardës Kombëtare gjatë një proteste politike në vitin 2011 përpara ndërtesës së Kryeministrit, që rezultoi në vdekjen e të afërmit të kërkuesve dhe tre protestuesve të tjerë, si dhe në plagosjen e disa protestuesve, të punonjësve të policisë dhe oficerëve të Gardës Kombëtare. Gjykata Evropiane gjeti mangësi në kuadrin ligjor mbi përdorimin e armëve të zjarrit në operacionet e kontrollit të turmave, defekte serioze në planifikimin dhe kontrollin e operacionit dhe dështim për të demonstruar se përdorimi i forcës vdekjeprurëse ishte absolutisht i nevojshëm (shkelje materiale e Nenit 2). Gjithashtu, u gjetën mangësi në fazat e hershme të hetimit (mosekzekutim i urdhër-arresteve, vonesë në dhënien e provave, shkatërrim i provave), mangësi për të hetuar në mënyrë adekuate përgjegjësinë nga ana e komandantëve dhe disa mangësi specifike në hetimin e vdekjes së të afërmit të kërkuesve (shkelje procedurale e Nenit 2).

Statusi i ekzekutimit

Përmbledhja më poshtë bazohet në informacionin e paraqitur nga autoritetet më së fundmi më 14 tetor 2024 në lidhje me *Durdaj dhe të tjerë* (DH-DD(2024)1173) dhe 5 nëntor 2024 në lidhje me *Nikën*. (DH- DD(2024)1288), si dhe në burime publike.

Masat individuale

Durdaj dhe të tjerë : Gjykata Evropiane konstatoi se rrethanat në të cilat ndodhi humbja e jetës dhe plagosjet e rënda u sqaruan në një masë të konsiderueshme në procedurat e mëparshme në lidhje me 29 persona (§§ 236 dhe 256), gjë që çoi në një përfundim të mosshkeljes sipas aspektit material. Në të kundërt, Gjykata Evropiane vendosi se duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë të tragjedisë së Gërdecit dhe provat e mbledhura në lidhje me ish-Ministrin e Mbrojtjes, FM, kërkuesit dhe publiku i gjerë kishin të drejtë të dinin rolin e saktë të ish-Ministrit të Mbrojtjes në këto ngjarje, i cili nuk ishte siguruar nga procedurat vendase.

Procedimi penal ndaj ish-Ministrit të Mbrojtjes F.M është në proces në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar (gjykata SPAK ¹). Autoritetet treguan se gjyqi është në fazën e marrjes së provave nga palët.² Sipas informacionit publik, gjyqi është shtyrë katër herë për shkak, *ndër të tjera*, të mungesës së avokatëve mbrojtës (të cilët janë gjobitur nga gjykata) dhe pjesëmarrjes së z. F.M në një aktivitet jashtë vendit.³ Autoritetet deklaruan se kërkuesit dhe të afërmit morën pjesë në gjyq personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre ligjor.

Nika : Vendimi i Gjykatës Evropiane tregon se në shkurt të 2023, familjarët e viktimave ngritën një padi të re. Informacioni publik (vendimi i Gjykatës së Lartë i marsit të 2024) tregon se, megjithëse të afërmit e tyre kishin identifikuar si të dyshuar të mundshëm ish-Kryeministrin e Shqipërisë, ish-Ministrin e Brendshëm dhe ish-Komandantin e Gardës Kombëtare, padia u rrëzua nga Prokuroria Speciale e SPAK (PS) dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Krimin e Organizuar në qershor të 2023 për shkak të mungesës së juridiksionit. Në mars të 2024, Gjykata e Lartë, duke marrë në konsideratë gjetjet e Gjykatës Evropiane, i rrëzoi këto vendime dhe urdhëroi PS të regjistronte procedimin penal. Hetimi rifilloi në korrik të 2024 dhe është në fazën e marrjes së provave.

Masat e përgjithshme

1) Përdorimi i armëve të zjarrit nga policia dhe Garda Kombëtare

a) Kuadri ligjor mbi përdorimin e armëve të zjarrit për operacionet e kontrollit të turmës

Një Ligj i ri për Armët e Zjarrit u miratua në vitin 2014 dhe parashikon rrethanat e jashtëzakonshme për përdorimin e armëve të zjarrit në operacionet e kontrollit të turmave. Armët e zjarrit mund të përdoren për të parandaluar sulme që kërcënojnë jetën e njerëzve, për të bërë arrestime, për të ndaluar krimet e vazhdueshme ose për të parandaluar arratisjet, kur ekziston një kërcënim real për jetën. Ato duhet të përdoren vetëm kundër individëve të armatosur që kryejnë akte të dhunshme si mjet i fundit kur masat e tjera dështojnë. Të shtënat në ajër për të shpërndarë turmat janë të ndaluara. Ligji gjithashtu kërkon të qëllohet me të shtëna paralajmëruese dhe urdhëron që të synohet pjesa e poshtme e trupit për të minimizuar dëmin. Kuadri i ri ligjor ende i referohet "zmbropsjes së një sulmi kundër një objekti të mbrojtur", por përmban një kusht të ri - që jeta e personelit përgjegjës për mbrojtjen e atij objekti (ose jeta e personave të tjerë) është qartësisht në rrezik. Oficerët e policisë duhet t'i nënshtrohen trajnimit për përdorimin e armëve të zjarrit.

Në vitin 2021, një ligj i ri për Gardën Kombëtare parashikoi rregullimin mbi përdorimin e armëve të zjarrit të ngjashme me atë të përcaktuar në Ligjin për Armët e Zjarrit, duke theksuar parimet e respektimit të të drejtave të njeriut dhe proporcionalitetit.

b) Udhëzime praktike për përdorimin e armëve të zjarrit

Kuadri i ri ligjor u plotësua me akte nënligjore që parashikonin një rregullore të detajuar mbi përdorimin e armëve të zjarrit dhe përshkruanin, ndër të tjera, llojet e armëve dhe municioneve të lejuara, ndalonin përdorimin e armëve të zjarrit në rastin e tubimeve/protestave paqësore, madje edhe të paligjshme, si dhe rregullonin skemën organizative dhe pajisjet e Gardës Kombëtare.

¹SPAK përfshin Prokurorinë e Posaçme (PS), Byroën Kombëtar të Hetimit (BKH) dhe gjykatat për korrupsionin dhe krimin e organizuar (gjykatat e SPAK-ut si të shkallës së parë ashtu edhe të apelit).

²Disa seanca dëgjimore ndaj ish-Ministrit të Mbrojtjes u zhvilluan në maj 2024; shtator 2024, tetor 2024 dhe së fundmi në shkurt 2025.

³Shihni lajmet (në shqip), të 11 dhjetorit 2024 dhe 25 marsit 2025 në mediat shqipe.

c) Përgjegjësia disiplinore për përdorimin e armëve të zjarrit nga policia

Ligji për Armët e Zjarrit lejon hetime administrative për përdorimin e armëve të zjarrit nga policia. Në janar të 2018, Ministri i Brendshëm miratoi një Udhëzim mbi krijimin dhe procedurat e Komisionit Disiplinor brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ky komision shqyrton rastet disiplinore që përfshijnë përdorimin e armëve të zjarrit dhe rekomandon sanksione për shkeljet e rregullave.

d) Planifikimi dhe kontrolli i operacioneve policore gjatë protestave

Në nëntor të 2024, autoritetet raportuan zbatimin e një sistemi gjithëpërfshirës masash (akteve nënligjore dhe në nivel operacional) që përmbajnë mbrojtje të mjaftueshme kundër arbitraritetit dhe abuzimit me forcën gjatë protestave.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë miratoi Procedurën Standarde të Operimit (PSO) në gusht të 2023 për "Planifikimin e operacioneve policore gjatë organizimit të tubimeve". Ajo përcakton, ndër të tjera, detyrimin për të përgatitur një plan të detajuar masash për menaxhimin e operacioneve gjatë protestave dhe që personeli i rregullt i policisë të kryejë detyrat e tij pa armë zjarri gjatë tubimeve ose protestave. Vetëm oficerët e Njësisë Speciale "RENEA", të cilët janë të trajnuar posaçërisht për këtë qëllim, mbajnë armë zjarri për ruajtjen e rendit.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit përgatit plane të detajuara për secilën protestë, të hartuara nga një grup pune që përfshin autoritetet lokale, shërbimet shëndetësore dhe zjarrfikëse. Policia është e pajisur me pajisje mbrojtëse dhe një oficer përgjegjës komunikon me udhëheqësit e protestës. Plani trajton veprimet e dhunshme, mësymjet dhe dëmtimin e pronës dhe përfshin bashkëpunimin me agjencitë shtetërore dhe ndarjen e informacionit me institucione të pavarura si Avokati i Popullit.

e) Trajnim profesional dhe masa ndërgjegjësimi

Autoritetet informuan mbi trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm për oficerët e Policisë së Shtetit dhe personelin e Gardës Kombëtare, duke mbuluar si kuadrin ligjor ashtu edhe vendosjen praktike të personelit për të siguruar sigurinë publike dhe të drejtat e njeriut. Ata nënvizuan se tubime dhe demonstrata të shumta që prej vitit 2014 kanë ndodhur pa probleme ose incidente specifike, duke demonstruar efektivitetin e kuadrit të përmirësuar ligjor dhe ndikimin e trajnimit.

2) Efektiviteti i hetimeve

a) Masat për të siguruar hetime efektive penale

Në tetor dhe nëntor të 2024, autoritetet prezantuan ndryshimet ligjore dhe institucionale që rezultuan nga reforma gjyqësore e vitit 2016. Ndryshimet kushtetuese decentralizuan sistemin e prokurorisë dhe forcuan pavarësinë e prokurorëve individualë nga Prokurori i Përgjithshëm, ky i fundit emërohet nga Parlamenti nga tre kandidatë të propozuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe nuk mund të japë udhëzime për rastet individuale. Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale (KPrP) në vitin 2017 forcuan më tej pavarësinë procedurale të prokurorëve, duke u lejuar prokurorëve të lartë të lëshojnë udhëzime për raste specifike, por këto nuk janë të detyrueshme.

Që nga dhjetori i vitit 2019, Prokuroria e sapokrijuar e SPAK është përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe akuzave penale kundër zyrtarëve të nivelit të lartë. Komisioni Evropian në Raportin e tij për Sundimin e së Drejtës për vitin 2024, ⁴theksoi rezultatet pozitive të SPAK-ut në hetimet, ndjekjet penale dhe dënimet e zyrtarëve të nivelit të lartë.

Autoritetet treguan se Neni 291.1 i KPrP-së tani kërkon që prokurorët të vendosin brenda 15 ditëve nëse do të fillojnë procedimin penal, duke siguruar që mosfillimi i hetimit të jetë vetëm kur rrethanat janë të qarta. Që nga viti 2017, ndryshimet mandatojnë hapjen e hetimit penal në rastet që përfshijnë vdekjen për shkak të përdorimit të forcës, neglizhencës mjekësore ose incidenteve të tjera, ose kur nevojiten veprime të mëtejshme hetimore. Nëse një prokuror vendos të pushojë një çështje pas hetimit, ai duhet të paraqesë një kërkesë te gjyqtari i seancës paraprake dëgjimore, i cili vendos sistematikisht për kërkesën për pushim.

⁴ Raporti i Komisionit Evropian për Sundimin e Ligjit mbi Shqipërinë (2024), f. 12

b) Pjesëmarrja e viktimave ose personave që kanë paraqitur kallëzim penal në procedurën penale

Ndryshimet e vitit 2017 në Kodin e Procedurës Penale forcuan të drejtat e viktimave në fazën paraprake të gjykimit. Viktimat tani kanë të drejtë të informohen për vendimet kryesore, të tilla si mosfillimi i hetimit; pushimi i një akuze ose çështjeje; arrestimi ose lirimi i të pandehurit. Ata mund të apelojnë kundër mosfillimit të hetimit, vendimeve të prokurorisë në fazën paraprake të gjykimit dhe pushimit të një çështjeje nga prokurorët ose gjyqtarët e procedurës paraprake dhe mund t'i kërkojnë një gjyqtari të urdhërojë ndjekje penale.⁵ Ata kanë të drejtë të thirren dhe të marrin pjesë në seancat paraprake dhe ato dëgjimore, si dhe të dëgjojnë nga gjykata në seancën paraprake dëgjimore mbi themelin e çështjes. Personat që kanë kallëzuar një krim duhet të njoftohen për vendimet për mosfillimin e procedimit, të cilat mund t'i apelojnë, dhe të informohen për kërkesat e prokurorisë për pushim, duke u lejuar atyre të marrin pjesë në seancat dëgjimore përkatëse.

Prokurori i Përgjithshëm nxori një Udhëzim në tetor të 2018 "Për Garantimin e Ndhmës për Viktimat dhe Dëshmitarët e Veprave Penale", i cili parashikon përgjegjësinë e prokurorit për të garantuar ushtrimin efektiv të të drejtave të viktimave. Ai përfshin një shtojcë me një letër që shpjegon të drejtat e viktimave për t'u informuar dhe për të apeluar kundër vendimeve të prokurorit gjatë hetimit paraprak.

Për më tepër, në dhjetor të 2023, Këshilli i Ministrave miratoi "Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030" dhe planin e saj të veprimit, me qëllim përafrimin me standardet evropiane⁶ dhe forcimin e të drejtave të viktimave për informacion, pjesëmarrje në procedurat penale dhe mbështetje të specializuara, veçanërisht për ata me nevojë të veçanta.

Analiza e Sekretariatit

Masat individuale

Lidhur me çështjen *Durdaj dhe të tjerë*, siguri i *restitutio in integrum* kërkon shmangien e çdo vonese të mëtejshme në procedimin penal në proces ndaj F.M dhe garantimin e pjesëmarrjes së kërkuar në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

Në këtë drejtim, mund të vërehet se, ndërsa që nga maji i 2024 janë mbajtur disa seanca dëgjimore në gjyqin në proces për shpërdorim detyrues ndaj F.M, gjyqi është shtyrë shpesh, pjesërisht për shkak të abuzimit procedural nga avokatët e të pandehurit, të sanksionuara nga gjykata vendase. Prandaj, propozohet t'u bëhet thirrje autoriteteve që të përdorin të gjitha mjetet në dispozicion për të shmangur vonesat e mëtejshme dhe për të informuar mbi ecurinë e gjyqit. Për më tepër, është pozitive që kërkuar dhe të afërmit e tyre tani marrin pjesë personalisht ose përmes përfaqësuesve të tyre ligjorë në gjyq. Megjithatë, për të vlerësuar nëse mundësitë për pjesëmarrje janë në përputhje me kërkesat e vendimit të GjEDNj, duket se janë të nevojshme sqarime, ndër të tjera nëse ata janë në gjendje të marrin në pyetje dëshmitarët, të paraqesin dokumentacion shtesë, të porosisin raporte ekspertësh, të paraqesin dëshmitarë, dhe të ankimojnë vendimet. (§ 225).

Lidhur me rastin *Nika*, është pozitive që Prokuroria e SPAK-ut rifilloi hetimin në korrik të 2024 dhe po bën përpjekje për të sqaruar rrethanat e përdorimit të forcës vdekjeprurëse. Megjithatë, duke pasur parasysh kohën e konsiderueshme që ka kaluar që nga këto ngjarje, mbetet thelbësore që autoritetet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që hetimi të kryhet dhe të përfundojë në kohën e duhur, si dhe të intensifikojnë përpjekjet e tyre për të shmangur humbjen e mëtejshme të provave ose vonesat.

Masat e përgjithshme

1) Përdorimi i armëve të zjarrit nga policia dhe Garda Kombëtare (shkelje materiale e Nenit 2)

a) Kuadri ligjor mbi përdorimin e armëve potencialisht vdekjeprurëse gjatë operacioneve të kontrollit të turmës

Komitetit i propozohet të vërë re me kënaqësi se, pas reformave legislative në vitet 2014 dhe 2021, si dhe miratimit të akteve nënligjore në vitet 2021 dhe 2022, duket se kuadri ligjor vendas tani është plotësisht në përputhje me Nenin 2 të Konventës. Ky kuadër përmban të gjitha mbrojtjet e kërkuara, të tilla si një listë të plotë të situatave në të cilat mund të përdoren armët e zjarrit dhe, për të gjitha këto situata, një domosdoshmëri absolute dhe testet e fundit, si dhe një tregues se armët e zjarrit mund të përdoren vetëm në rast kërcënimi për jetën. Ai gjithashtu përmban rregulla për të shtënë paralajmëruese dhe për minimizimin e çdo dëmi. Për më tepër, legjislati i dytësor i miratuar rishtazi ofron udhëzime praktike dhe rregullon në detaje përdorimin e armëve të zjarrit.

⁵Çështjet e mësipërme rregullohen nga neni 58, neni 291, nenet 329/a, 329/b dhe 329/ç të Kodit të Procedurës Penale.

⁶Strategjia e BE-së për të drejtat e viktimave (2020-2025).

b) Planifikimi dhe kontrolli i operacioneve policore gjatë protestave

Gjithashtu, duhet theksuar me kënaqësi se autoritetet kanë prezantuar një kuadër gjithëpërfshirës, nëpërmjet akteve nënligjore dhe masave praktike, i cili siguron planifikim dhe kontroll të përshtatshëm. Procedurat e qarta standarde të operimit, rregulli që oficerët e zakonshëm të policisë kryejnë operacione pa armë zjarri dhe që gjatë tubimeve vetëm forcat e njësisve speciale të trajnuara posaçërisht mund të përdorin armë zjarri në rrethana të kufizuara të parashikuara nga ligji, duket se janë të afta të përmirësojnë sigurinë e operacioneve policore. Detyrimi për të përgatitur një plan të detajuar për çdo tubim, bashkëpunimi me palë të ndryshme të interesuara, disponueshmëria e mjeteve jo-vdekjeprurëse për kontrollin e turmës dhe ekzistenca e një zinxhiri të qartë komande dhe kanalesh komunikimi ndërmjet strukturave të policisë dhe udhëheqësve të tubimit janë gjithashtu të rëndësishme për të siguruar ndërhyrje koherente dhe të sigurta policore. Autoritetet mund të sqarojnë nëse hartohet një raport pas çdo proteste.

c) Trajnim profesional dhe masa ndërgjegjësimi

Është pozitive që oficerët e Policisë së Shtetit dhe personeli i Gardës Kombëtare janë trajnuar sistematikisht dhe se që nga viti 2014 demonstratat kanë zhvilluar në një atmosferë të qetë dhe nuk kanë ndodhur incidente të ngjashme që përfshijnë përdorimin e armëve të zjarrit nga agjentët shtetërorë. Ky është një tregues i ndikimit pozitiv të legjislacionit dhe trajnimit të ndryshuar. Për të lejuar një vlerësim të plotë, do të ishte e dobishme të jepeshin informacione mbi zbatimin e kuadrit të ri në situata të tjera përveç protestave, në të cilat lejohet përdorimi i armëve të zjarrit nga policia (p.sh., mbi rrethanat në të cilat janë përdorur armët e zjarrit në të vërtetë, mbi situatat e identifikuar të përdorimit të paligjshëm, ose ndoshta informacione statistikore mbi frekuencën e përdorimit dhe numrin e incidenteve që rezultojnë në lëndime ose vdekje, etj.).

2) Efektiviteti i hetimeve në fazën paraprake dhe të gjyqimit (shkelje procedurale të Nenit 2)

a) Hetime penale efektive në fazën paraprake të gjyqimit

Pas ngjarjeve në këto raste, reformat kushtetuese dhe legjislative adresuan disa nga mangësitë e identifikuar nga Gjykata Evropiane. Në kohën e ngjarjeve, prokuroria ishte e organizuar në një mënyrë hierarkike, me Prokurorin e Përgjithshëm, të zgjedhur nga parlamenti, kompetent për të dhënë udhëzime në një rast specifik, ndërsa vendimet për të mos ndjekur penalisht ose hetuar nuk rishikoheshin automatikisht nga një gjyqtar. Për pasojë, reformat kanë rritur pavarësinë institucionale, kanë përmirësuar koordinimin dhe mbikëqyrjen e veprimeve prokuroriale. Ato gjithashtu kanë vendosur masa mbrojtëse më të forta për garantimin e efektivitetit të ndjekjes penale dhe parandalimin e ndërhyrjeve politike. Masat kryesore përfshijnë decentralizimin e prokurorisë, kërkesën që parlamenti të zgjedhë kandidatët e miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe shqyrtimin gjyqësor të vendimeve për të mos hetuar ose ndjekur penalisht - qoftë mbi ankesat për mosfillimin e hetimit ose sistematikisht në rastet e pushimit të çështjes. Rezultatet e PS të SPAK në ndjekjen penale të rasteve të profil të lartë duket se konfirmon ndikimin pozitiv të këtyre reformave. Këto përmirësime duhet të mirëpritën.

Për më tepër, të drejtat e viktimave në fazën paragjyqësore, të cilat u gjetën të pamjaftueshme në rastin *Nika*, janë përforcuar duke u dhënë atyre mundësinë për të përdorur mjete juridike për të kundërshtuar mosfillimin e hetimeve dhe ndjekur penalisht dhe duke u dhënë të drejta të ndryshme në fazën paragjyqësore.

Është gjithashtu pozitive që personat që kanë paraqitur një kallëzim penal ose ankesë njoftohen për disa vendime në fazën paraprake të gjyqimit dhe u lejohet të ankimojnë një vendim për të refuzuar fillimin e hetimit penal dhe të marrin pjesë në seancën dëgjimore në lidhje me një kërkesë të prokurorisë për të pushuar një çështje ose akuzë. Këto reforma duket se u japin palëve të dëmtuara të drejtën për të marrë pjesë në procedurat paraprake dhe për të kundërshtuar vendimet e prokurorisë për të gjitha llojet përkatëse të veprave penale, duke përfshirë ato që përfshijnë përgjegjësinë e komandantëve dhe zyrtarëve të nivelit të lartë në incidente që lidhen me plagosje ose humbje jete.

Përveç kësaj, është e nevojshme të ofrohen informacione se si kuadri i ri ligjor siguron, në ligj dhe në praktikë, përshtatshmërinë, shpejtësinë dhe kujdesin e hetimit (duke përfshirë pajtueshmërinë me udhëzimet e prokurorisë, ruajtjen e provave, shqyrtimin e duhur të pistave të dukshme të hetimit, duke përfshirë edhe në lidhje me zyrtarët e rangut të lartë).

Është gjithashtu e dobishme të paraqiten (i) statistika ose (ii) informacione mbi praktikën prokuroriale dhe gjyqësore në lidhje me rastet e hetuara dhe të ndjekura penalisht që përfshijnë aktivitete kërcënuese për jetën ose të rrezikshme ose përdorim të armëve të zjarrit nga agjentët shtetërorë, dhe mbi rezultatet e këtyre rasteve, në mënyrë që të lehtësohet vlerësimi i ndikimit të masave. Për më tepër, duket e rëndësishme të ofrohen (iii) informacione specifike mbi dispozitat e zbatueshme të ligjit penal dhe praktikën prokuroriale dhe gjyqësore në lidhje me përgjegjësinë penale të zyrtarëve përgjegjës për planifikimin dhe kontrollin e operacioneve.

b) Pjesëmarrja e palës së dëmtuar në fazën e gjykimit të procedurës penale

Ndërkohë që autoritetet kanë miratuar shumë reforma pozitive, duket se të drejtat e viktimave garantohen kryesisht në fazën paraprake dhe në një masë më të vogël në fazën e gjykimit. Në të vërtetë, ndryshimet ligjore të paraqitura nga autoritetet nuk duket se garantojnë pjesëmarrjen e palëve të dëmtuara në gjykim në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre, në situata kur pala e dëmtuar nuk ka ngritur një padi civile, ose padia civile është ndarë nga procedura penale. Në këto situata, kuadri aktual nuk duket se parashikon një numër të drejtash procedurale (të drejtën për të paraqitur prova, për të bërë komente mbi provat e mbledhura, për të pyetur dëshmitarët ose të pandehurit, për t'u njoftuar për vendimet ose gjykimet e marra në procedurën penale dhe për të apeluar kundër vendimeve ose gjykimeve të tilla).

Prandaj, Komitetit i propozohet t'i ftojë autoritetet të vlerësojnë se si garantohen këto të drejta, në ligj dhe në praktikë, për viktimat dhe të afërmit e tyre në fazën e gjykimit, dhe nëse janë të nevojshme masa të mëtejshme ligjore në këtë drejtim.

c) Hetimet disiplinore

Do të ishte e dobishme që autoritetet të ofrojnë informacion më të detajuar mbi kuadrin dhe praktikën në lidhje me zbatimin e përgjegjësisë disiplinore për përdorimin e paligjshëm të armëve të zjarrit, duke përfshirë edhe si një mjet për të sqaruar përgjegjësitë për planifikimin dhe kontrollin e operacioneve nga zyrtarët e nivelit të lartë. Ata gjithashtu mund të ftohen të sqarojnë se si viktimat, në situata të justifikuara, mund të marrin dijeni të mjaftueshme dhe në kohë për rezultatin e tyre.

Financim i garantuar: PO
